

VENDIM
Nr.1197, datë 3.12.2009

**PËR SHPALLJEN E KALASË SË TIRANËS “ZONË ARKEOLOGJIKE “A”” DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË SAJ**

(Ndryshuar me VKM nr.303 datë 20.04.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e rregullores së administrimit të Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen *Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Urban* dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E ADMINISTRIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË KALASË SË TIRANËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllin përcaktimin e rregullave për administrimin dhe zonifikimin e zonës arkeologjike “A” të Klasës së Tiranës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar).

Neni 2

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A”

Në zonën arkeologjike “A” të Kalasë së Tiranës lejohet:

1. *Konservimi dhe restaurimi i mureve rrethuese dhe strukturave të tjera arkeologjike të kalasë, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

2. *Konservimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës që përfshihen brenda kufijve të zonës arkeologjike mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

3. *Rikonstruksioni i rrugëve në të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.*

4. *Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi maksimale 1 kat, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.*

Konstruksionet, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, në veçanti, dhe trashëgiminë kulturore, në përgjithësi, si dhe nevoja të tjera të rikualifikimit urban të zonës, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe, në asnjë rast, nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin.

Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë qartë qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Vendosja e tyre bëhet me mbikëqyrjen e autoriteteve të specializuara shtetërore.

Neni 3

Në studimet urbanistike për qendrën e Tiranës duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i Kalasë së Tiranës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht bazuar në të dhënat e reja arkeologjike si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 5

Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet:

1. Harta e zonifikimit me koordinatat përkatëse gjeografike të marra GPS (Garmin 60).

ZONA ARKEOLOGJIKE "A" E KALASË SË TIRANËS

